




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë të datës 17.06.2020 me Nr.02/06 dhe Udhëzimet e Qeverisë së Kosovës që kanë të bëjnë me menaxhimin e pandemisë COVID-19, Manualit për Mbrojtje nga Përhapja e Virusit Covid-19, Shtabi Komunal për Menaxhimin e Pandemisë dhe Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Në bazë të këtij vendimi lirohen punëtorët mbi moshën 55 vjet, nënat dhe punëtorët me sëmundje kronike deri në përmirësimin e gjendjes aktuale të krijuar nga pandemia Covid-19.
- II. Obligohen Drejtoritë komunale që të gjejnë formën e përshtatshme që ti kryejnë detyrat dhe përgjegjësit e punës me staf të reduktuar.
- III. Obligohen zyrtarët komunal që mos të pranojnë palë pa mjete mbrojtëse.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit dhe vlen deri në një vendim tjetër.

Të bashkëngjitur me këtë vendim e gjeni edhe vendimin e Qeverisë me Nr. Ref. 02/06

V. Me këtë vendim njoftohen:

- Zyra e Kryetarit
- Drejtoritë e komunës
- Arkivi i komunës

Deçan, 19.06.2020





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/06

Datë: 17.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4), si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, si dhe pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë

1. Të gjitha Institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës obligohen të organizojnë punën me stafin e tyre (në distancë fizike apo nga shtëpitë e tyre/online) në funksion të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë bazuar në legjislacionin në fuqi;
2. Të gjitha Institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës obligohen të shtojnë kontrollë rigoroze të bartjes së maskave në hyrje të çdo institucioni.
3. Të gjitha Institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës obligohen të organizojnë punën me stafin e tyre në përputhje të plotë me Manualin për mbrojtjen nga përhapja e virusit Covid 19;
4. Obligohen institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Inspektoratet relevante të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi;
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh se në javën e fundit kemi rritje të rasteve pozitive, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës